



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:253540

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06381553

Në çështjen juridike të :

AC-I-23-0579-A0001

Paditësi/Ankuesi

R K fshati R, Suharekë.

Kundër:

E paditura

N.SH “25 Maji” (në likuidim), Suharekë, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-0787, të datës 28 shtator 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 31 tetor 2024, me shumicë votash lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e paditësit aprovohet si e bazuar.
2. Ndryshohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-0787, i datës 28 shtator 2023 si dhe vendimet e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ045-0260, PRZ045-0261, dhe PRZ045-0262, që të tre të datës 31 janar 2014.
3. Obligohet e paditura AKP-ja që në emër të tre pagave të papaguara për muajt janar-mars 2009 t'i paguaj paditësit shumën prej 1,230.00 euro, në emër të ndërprerjes së parakohshme

të kontratës së punës shumë prej 2,870.00 euro, si dhe në emër të kompensimit për 18 paga të pa paguara për periudhën 1 korrik 2007 deri 31 dhjetor 2008 shumë prej 7,380.00 euro, të cilat do t'i paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 13 shkurt 2014, ankuesi ka parashtruar një ankesë kundër Vendimeve të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ045-0260, PRZ045-0261 dhe PRZ045-0262, të gjitha të datës 31 janar 2014. Kërkesa 0260 kishte për bazë kompensimin për 3 paga të papaguara në vlerën prej 1,230.00 euro, kërkesa 0261 kishte për bazë kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 2,870.00 euro dhe kërkesa 0262 kishte për bazë kompensimin për 18 paga të papaguara për periudhën nga 1 korrik 2007 deri me 31 dhjetor 2008 në shumë prej 7,380.00 euro. Të gjitha kërkesat ishin refuzuar si të pavlefshme me arsyetimin se ato kishin arritur afatin e parashkrimit.

Në ankesë paditësi ishte theksuar se e paditura në të gjitha vendimet e saj thirret me pretendimet e saj se brenda afatit prej 3 viteve nga dita e likuidimit të ndërmarrjes, këta punëtorë kanë pasur të drejtën e parashkrimit të ankesës apo kërkesës për kompensim ndërsa tani kanë humbur këtë të drejtë por fsheh faktin se e paditura fare nuk ka dhënë udhëzim juridik të cilit është dashur ti përmbahen këta punëtorë, të cilëve u është shkaktuar shkelje e satisfaksionit moral ngase ai material veç nënkuptohet nga vet vendimet. Andaj, paditësi i kishte propozuar gjykatës që të aprovohet si e bazuar padia e paditësit, ndërsa të detyrohet e paditura që të bëjë kompensimin e dëmit të shkaktuar material në vlerën si në kërkesa dhe kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Me datë 5 maj 2023, gjykata kishte lëshuar një urdhër për ankuesin nga i cili kishte kërkuar që të dorëzoj vendimet e ankimuara të Autoritetit të Likuidimit dhe provat relevante në mbështetje të ankesës së tij.

Me datë 23 maj 2023, paditësi me anë të një parashtrëse ishte përgjigjur në urdhrin e lartcekur të gjykatës dhe kishte dorëzuar në DHPGJS këto dokumente: kopjen e letërnjoftimit të paditësit, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 27 mars 2009 si dhe

vendimet e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ045-0260, PRZ045-0261 dhe PRZ045-0262, të gjitha të datës 31 janar 2014.

Me datë 15 qershor 2023, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën kishte theksuar se duke qenë se privatizimi i N.SH-së ka hyrë në fuqi me datën 26 mars 2009, të gjitha marrëdhëniet e punës ekzistuese me punëtorët janë ndërprerë automatikisht po në këtë datë. Pra të gjitha kërkesat e punëtorëve për paga duhet të ishin parashtruar nga kërkuesit më së voni deri me datë 26 mars 2012, e që nënkupton tre vite duke filluar nga data e privatizimit. Andaj, Autoriteti i Likuidimit kishte ardhur në përfundim se kërkesat e paditësit për paga të papaguara dhe për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës janë të parashkruara. Andaj, i kishte propozuar gjykatës që të refuzoj ankesën e paditësit si të pabazuar dhe të vërtetoj vendimet e ankimuara të Autoritetit të Likuidimit. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimet e ankimuara të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ045-0260, PRZ045-0261 dhe PRZ045-0262, të gjitha të datës 31 janar 2014 si dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit të datës 1 nëntor 2022.

Me datë 28 shtator 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-0787 kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe kishte vërtetuar vendimet e ankimuara të Autoritetit të Likuidimit. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi ishte vlerësuar se kërkesat në fjalë të ankuesit nuk janë të mbështetura në asnjë provë apo dëshmi dhe si të tilla janë të pabazuara. Ankuesi nuk kishte ofruar ndonjë dëshmi relevante në procedurë të likuidimit por as në kohën e parashtrimit të ankesës në gjykatë kundër vendimeve të AL-së, me të cilat do të dëshmonte se i njëjti ka ofruar shërbime pune për N.SH dhe se N.SH detyrohet për kompensimin e pagave të pretenduara. Ankuesi nuk kishte dorëzuar asnjë provë apo dëshmi të vetme në ankesën e tij. E vetmja dëshmi e dorëzuar nga ankuesi është njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës e lëshuar nga AKP me datë 27 mars 2009 e cila si dëshmie vetme nuk mbështetë mjaftueshëm pretendimet e ankuesit në lidhje me ndonjë nga kërkesat e tij.

Me datë 12 tetor 2023, paditësi (ankuesi) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-14-0787 të datës 28 shtator 2023 (aktgjykimi i ankimuar), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimin e gabuar të dispozitave materiale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të miratoj si të bazuar ankesën e ankuesit dhe të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar duke aprovuar ankesën e parashtruar nga ankuesi apo çështjen ta kthej në rigjykim në shkallë të parë të DHPGJS-së për

rivendosje në mënyrë meritore. Ankuesi në ankesë kishte theksuar se sa i përket pikës II të Aktgjykimit të paraqitur gjykata nuk e ka bërë çmuarjen e provave në mënyrë të drejtë pasi që AKP si palë e paditur në asnjë nga fazat e procedurës nuk e ka mohuar faktin se parashtruesi i ankesës ka qenë punëtor i N.SH-së, nuk ka mohuar faktin se parashtruesi i kërkesës ka pasur 18 paga të papaguara si dhe faktin kryesor se i njëjti është larguar përkatësisht i është ndërprerë kontrata në mënyrë të parakohshme dhe se i takojnë pagat e papaguara. Se ankuesi ka qenë punëtor i N.SH-së në fjalë vërtetohet përmes librezës së punës, ku ankuesi ka qenë punëtor nga data 1 tetor 1977 deri me 27 mars 2009, që përkon edhe me kohën në bazë të së cilës kërkohet kompensimi i pagave të papaguara dhe pagave përcjellëse, kurse vitet tjera të përvojës së punës janë në ndërmarrje tjera që poashtu mund të vërtetohet me librezën e punës së paditësit. Andaj, duke i pasur parasysh këto që u thanë ankuesi i kishte propozuar Kolegjit të Apelit si më lartë. Ankesës i kishte bashkëngjitur njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 27 mars 2009, njoftimin për fillimin e likuidimit të ndërmarrjes në fjalë të datës 6 shtator 2013, listën e pagave për punëtorët e N.SH “25 Maji”, Therandë për muajt janar-mars 2009 si dhe kopjen e librezës së punës së paditësit.

Me datë 20 maj 2024, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesën e paditësit në të cilën kishte theksuar se përsëritja e argumenteve që janë parashtruar më parë do të ishte e padobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye i kishte propozuar Kolegjit të Apelit të refuzoj apelin si të pabazuar dhe të vërtetoj Aktgjykimin e ankimuar.

Arsyetimi i ligjor

Ankesa e paditësit aprovohet si e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS lidhur me pjesën e kërkesave për tre paga të papaguara për muajt janar-mars 2009 (PRZ045-0260 të datës 31 janar 2014), për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës PRZ045-0261 të datës 31 janar 2014) si dhe për kompensim për për 18 paga të papaguara për periudhën nga 1 korrik 2007 deri

me 31 dhjetor 2008 në shumën prej 7,380.00 euro dhe ankesa e paditësit lidhur me këto kërkesa aprovohet si e bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesat e paditësit për tre pagat e papaguara në shumën prej 1,230.00 euro, kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 2,870.00 euro si dhe kërkesa për kompensimin e 18 pagave të papaguara për periudhën nga 1 korrik 2007 deri me 31 dhjetor 2008 në shumën prej 7,380.00 euro, nga Autoriteti i Likuidimit ishin refuzuar si të pavlefshme me arsyetimin se ato kishin arritur afatin e parashkrimit.

Kolegji i Apelit ka vërejtur se paditësi në shkallë të parë kishte bashkëngjitur si provë njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 27 mars 2009.

Shkalla e parë e DHPGJS-së i kishte trajtuar këto kërkesa dhe kishte vlerësuar se kërkesat në fjalë të ankuesit nuk janë të mbështetura në asnjë provë apo dëshmi dhe kështu e kishte refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar.

Me rastin e paraqitjes së ankesës pranë Kolegjit të Apelit, paditësi kishte bashkëngjitur edhe këto prova në mbështetje të ankesës së tij dhe atë njoftimin për fillimin e likuidimit të ndërmarrjes në fjalë të datës 6 shtator 2013, listën e pagave për punëtorët e N.SH “25 Maji”, Therandë për muajt janar-mars 2009 si dhe kopjen e librezës së punës së paditësit.

Në këtë rast sipas nenit 70 të Ligjit për DHPGJS, Kolegji i Apelit vendosi t’i pranoj këto prova në interes të drejtësisë.

Kolegji i Apelit i DHPGJS-së konsideron që refuzimi i tërësishëm i kërkesave të paditësit nuk ishte veprim i drejtë nga ana e Autoritetit të Likuidimit dhe as nga ana e shkallës së parë të DHPGJS-së.

Kjo për faktin se fillimisht nga kopja e librezës së punës së paditësit shihet se i njëjti ka ofruar shërbime pune për N.SH-në deri në ditën e privatizimit të saj dhe atë me datë 27 mars 2009, ditë kjo kur edhe i ishte mbyllur librezja e punës. E nga kjo rezulton se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës si rezultati veprimit/vendimit të AKP-së.

Tutje, nga njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit i dorëzuar si provë në shkallë të parë, me të cilin njoftim paditësit i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 27 mars 2009, i njëjti ishte udhëzuar nga AKP-ja që *“Shumat-Pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me Punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e Punëdhënësit. Kërkesat*

e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura". I njëjti në rastin konkret kishte vepruar konform udhëzimeve të AKP-së të paraqitura në njoftim dhe e kishte paraqitur kërkesën e tij pranë AL-së brenda afatit të paraparë ligjor.

Andaj, nga këto arsye Kolegji i Apelit i njeh paditësit të drejtën në dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës në shumën e kërkuar prej 2,870.00 euro, e cila do t'i paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit

Tutje, sa i përket kërkesës së paditësit për tre paga të papaguara për muajt janar-mars 2009, Kolegji i Apelit vëren se N.SH i kishte mbetur borxh paditësit pagat e papaguara për muajt janar-mars 2009. Meqenëse në bazë të listës në fjalë shihet se paga e tij mujore neto ishte 410.00 euro atëherë $410.000 \times 3 = 1,230.00$ euro.

Prandaj, Kolegji i Apelit duke u bazuar në listën e pagave të lartcekur i njeh paditësit të drejtën në kompensim për tre pagat e papaguara për periudhën janar-mars 2009 në shumën prej 1,230.00 euro, e cila shumë do t'i paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Tutje, sa i përket kërkesës së paditësit lidhur me kompensimin e 18 pagave të papaguara për periudhën nga 1 korrik 2007 deri me 31 dhjetor 2008 në shumën prej 7,380.00 euro, Kolegji i Apelit konsideron se paditësit i takon e drejta në kompensimin e për pagat e pa paguara për periudhën 1 korrik 2007 deri me 31 dhjetor 2008 në shumën prej 7,380.00 euro.

Prandaj, Kolegji i Apelit duke u bazuar në listën e pagave të lartcekur i njeh paditësit të drejtën në kompensim për pagat e papaguara për periudhën 1 korrik 2007 deri me 31 dhjetor 2008 në shumën prej 7,380.00 euro e cila shumë do t'i paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

AKP-ja gjatë gjithë fazave të procedurës së zhvilluar me shkrim ishte thirrur vetëm në parashkrimin e kërkesës dhe në asnjë rast nuk e ka kontestuar punësimin apo punën e tij në N.SH si dhe lartësinë e shumave të kërkuara nga paditësi. Faktet e pakontestuar konsiderohen si të provuara në bazë të nenit 42.2 të LDHP-së.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa e paditësit duhet të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 31 tetor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues _____